

**i** FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:  
Informacion për pacientin

# NEOCIL

Tableta të veshura me film – 500 mg  
(Ciprofloksacinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpresa se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar eshtë përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund t'kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësoshet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi t' njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Neocil dhe përsë përdoret
- Përpresa se të merrni Neocil
- Si ta merrni Neocil
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Neocil
- Informacion i mëtejshëm

## 1. ÇFARË ËSHTË NEOCIL DHE PËRSE PËRDORET

Neocil përbën lëndën vepruese ciprofloksacinë klorhidrat. Ciprofloksacina është një fluorokinolon antibakterial me një spektër të gjërë veprimi. Ciprofloksacina është baktericide dhe frenon enzimën ADN - xhirazë (topoizomerazë) e cila është kryesore në riprohimin e ADN bakteriale. Ajo ka një spektër të gjërë veprimi dhe është më e fuqishme se jo-fluorokinolonet (acidi nalidiksik). Aktiviteti i saj reduktohet në mijdisi acid. Ndërmjet baktereve aerobe gram – negative, ciprofloksacina është aktive in vitro kundër baktereve aerobe gram – pozitive, ciprofloksacina është aktive in vitro kundër stafilokot. Ciprofloksacina nuk është aktive kundër baktereve anaerobe. Ciprofloksacina ka të njëjtin veprim kundër mykobakterieve, mykoplaszave, rikecieve dhe protozoarëve.

Ciprofloksacina përthithet shpejt nga trakti gastrointestinal. Biodisponibiliteti oral është afersisht 70% dhe përqëndrimi i pikut plazmatik është rreth 2.5 µg / mL që arrihet për 1 - 2 orë pas dozës prej 500 mg të marrë nga goja. Përthithja vonohet nga prania e ushqimit, por nuk është esenciale përfektin oral.

Ciprofloksacina kalon barrierën placentare dhe është gjithashtu e shpërndarë në qumështin e gjirit. Përqëndrime të larta janë gjetur në tëmth.

Ciprofloksacina eleminohet kryesisht nga sekretimi urinar, por kështu jo-urinar ka një sasi prej 1 / 3 e eliminimit duke përfshirë metabolizmin në mëlçi,

sekretimin në tëmth dhe mundësinë e sekretimit translumenal duke kaluar mukozat intestinale. Më pak se 4 metabolismi aktivë janë identifikuar. Neocil përdoret në një shkallë të gjërë të infeksioneve përfshirë: antraksin, infeksionet e traktit biliar, infeksione të kockave dhe artikulacioneve, infeksione të traktit respirator, infeksione të veshit, syrit, hundës dhe grykës, infeksione të traktit urinar, infeksione të lëkurës dhe indeve të buta, infeksione gastrointestinale, infeksione intraabdominale, infeksione pelvike, infeksione nga pickmet ose djegjet, gonorrenë dhe infeksione pas ndërhyrjeve kirurgjikale në pjesët e sipërme të traktit gastrointestinal.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI NEOCIL

### Mos merrni Neocil:

- në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj ciprofloksacinës dhe përfaqësuesve të tjerë të klasës së kinoloneve si dhe ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Neocil.

### Tregoni kujdes të veçantë me Neocil

Pyesni mjekun tuaj përpresa se të merrni Neocil. Neocil duhet përdorur me kujdes në fëmijët, adoleshentët (më pak se 18 vjeç).

### Duhet të evitohet përdorimi tek gratë shtatzëna dhe ato që i jepin gjithë fëmijëve.

### Marrja e barnave të tjera:

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Neocil. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Neocil në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtit.

Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- katione si: alumini, magnezi ose hekuri, të cilët reduktojnë përrthithjen e ciprofloksacinës dhe lidhen me barin kur jepet i shqëruar;
- antagonistë të receptorëve H2 të histaminës sepse janë vënë re ndryshime në farmakokinetikën e fluorokinoloneve duke ndryshuar pH gastrik;
- teofilinë, sepse ciprofloksacina rrit përqëndrimin plazmatik të teofilinës duke rritur rrezikun e konvulsioneve;
- antikoagulantë, ciprofloksacina rrit efektin antikoagulant të kumarinave (varfarinë);
- antidiabetikë, rrit efektin e glibenklamidit;
- antiepileptikë, ciprofloksacina rrit ose ul përqëndrimin plazmatik të fenitoïnës;
- antipsikotikë, rrit përqëndrimin plazmatik të klozapinës dhe mund të rrisë përqëndrimin e olanzapinës;
- citostatikë, mund të redukojë jashtëqitjen e metotreksatit (ritt rrezikun e toksicitetit);
- dopaminerjikë, ciprofloksacina pengon metabolismin e ropinirolit (ritt përqëndrimin plazmatik);

- probencid, redukton jashtëqitjen e ciprofloksacinës.

### Shtatzënia

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpresa se të merrni këtë bar. Neocil nuk duhet të merret gjatë periudhës së shtatzënisë (Kategoria C).

### Ushqimi me gji

Neocil nuk duhet të merret gjatë ushqyerjes me gji të foshnjave.

## 3. SI TA MERRNI NEOCIL

Gjithmonë merrni Neocil sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontakti me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Neocil janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Doza orale për të rritur është si më poshtë:

- në infeksionet e traktit respirator është 250 - 750 mg dy herë në ditë
- në infeksionet e traktit urinar është 250 - 500 mg dy herë në ditë
- në cistit akut tek gratë 100 mg dy herë në ditë për 3 ditë
- në gonorre, 250 mg si një dozë e vetme; 500 mg në rastet rezistente
- në rastet e infeksioneve të ulëta të traktit respirator në fibrozën cistike, 750 mg dy herë në ditë.

Fëmijët: 5 - 17 vjeç, 20 mg / kg dy herë në ditë në infeksione të traktit urinar (maksimumi 750 mg / dozë);

- në infeksionet e tjera, 500 – 750 mg dy herë në ditë;
- në profilaksinë kirurgjikale, 750 mg e administruar 60 - 90 minuta përpresa ndërhyrjes. Megjithatë doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose përtu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përpunje me rrethanat.

### Në qoftë se keni marrë më shumë Neocil:

Në qoftë se keni marrë më shumë Neocil se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerrin.

### Në qoftë se keni harruar të merrni Neocil:

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur t'jetë koha përmarrjen e zakonishtë të sësaj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË NEOCIL

Si të gjithë barnat e tjera, Neocil mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme

anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Neocil në përgjithësi tolerohet mirë por më dendur shfaq efekte të padëshiruara në:

- traktin gastrointestinal (të përziera, të vjella, diarre, dhimbje abdominale dhe dispepsi që janë më të shpeshtë; koliti pseudomembranozë është hasur rrallë);
- SNQ (dhimbje koke, marrje mendsh dhe nervozizë janë më të shpeshtë; të tjera efekte anësore janë dridhje, përgjumje, pagjumësi, ankh, çregullime të ndjeshëmërisë si dhe rrallë halucinacione dhe çregullime psikotike, depresion);
- lëkurë (prurit dhe të kraujtura, reaksione të tipit të mbindjesëmërisë, dhe rrallë vaskularizim, eritema multiiforme, sindrom Stevens - Johnson dhe nekrolizë epidermale toksike);
- çregullime të heparit. Të tjera efekte anësore janë: rritje e kreatininës në serum ose rritje e urenës në gjak dhe më rrallë mund tă japë kristaluri, insuficencë renale dhe nefrit. Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkësoshet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI NEOCIL

Mbajeni larg fëmijëve.

Mos e përdorni Neocil pas datës së skadimit e cilështë e shënuar në paketim. Ruajeni në temperaturën 25°C!

Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përbën Neocil - Tabletë e veshur me film

Lënda vepruese është Ciprofloksacinë klorhidrat. Çdo tabletë e veshur me film përbën 581.9 mg ciprofloksacinë klorhidrat që është ekuivalent me 500 mg ciprofloksacinë bazë. Përbërësit e tjerë janë: celulozë mikrokristalore, stearat magnezi, dioksid silici koloidal, kroskarmelozë natriumi, glikolat natriumi i amidonit, laurilsulfat natriumi, povidon, opadry II i bardhë.

### Përbajtja e paketimit

Forma e paketimit: kuti me 10 tabletë të veshura me film.

### Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

! Mund të merret pa recetën e mjekut.

! Përbajtja. ! Kujdes. Forma e tabletës.

Mbjatësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

 PROFARMA Sh.a.  
Rruga "Myslym Keta"  
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800  
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Maj 2013.

**PAY ATENTION**, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.